

PROJEKT LIGJ

Nr. _____, datë ____ . ____ .2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 273, DATË 29.04.2010 “PËR DOKUMENTIN ELEKTRONIK”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

Në ligjin nr.10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në Nenin 3, “Përkufizime” pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“12. “Vulë elektronike” janë të dhëna në forme elektronike sipas përkufizimit të ligjit 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.

Neni 2

Neni, 6 pika a), riformulohet si më poshtë:

“a) Nënshkrim elektronik ose vule elektronike, ose të dyja së bashku, sipas legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”

Neni 3

Në nenin 7, pika b), pas togfjalëshit “nënshkrime elektronike” shtohet togfjalëshi: “ose vula elektronike ose të dyja së bashku”.

Neni 4

Në nenin 12, pika 2), pas togfjalëshit “nënshkrimit elektronik” shtohet togfjalëshi: “ ose vulës elektronike ose të dyjave së bashku”

Neni 5

Në nenin 13, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me përmbajtje:

“Procedura dhe rregullat për qarkullimin e dokumentit elektronik, përcaktohen me vendim të Këshilli i Ministrave”.

Neni 6

Në nenin 18 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 3/a, pas togfjalëshit “të dhënat e nënshkrimit elektronik” shtohet togfjalëshi: “ose vulës elektronike ose të dhëna të të dyjave së bashku”.
2. Në pikën 3/b, pas togfjalëshit “se bashku me nënshkrimin elektronik” shtohet togfjalëshi: “ose vulën elektronike ose të dyja së bashku”

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare